



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA BERAT

Berat, më

05.06.2018

### FORMULAR I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin Ekonomik " MANE/S"sh.p.k me NIPT J64103865K  
me adresë : SARANDE

Procedura e prokurimit " Kërkesë për propozim " me mjete elektronike

Numri i referencës së procedurës/lotit REF-65465-04-26-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: (sasitë , qellim kohezgjatja)

#### " Restaurim i mureve te Kalase Berat"

Kohëzgjatja e kontrates ose afati kohor për ekzekutim: Afati deri në mbarimin e vleres të kontratës sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike  
[Data 30.04.2018] [Numri 17].

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit : cmimi më i ulët , X oferta ekonomikisht më e favorshme  
Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë pesë ofertues me vlerë përkatëse të ofruar:

1. "COLOMBO" sh.p.k. me NIPT J82916489E me ofertën: 6 311 555 (gjashtë million e treqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.
2. "JOGI" sh.p.k me NIPT J63229478K me ofertën: 6 752 550 (gjashtë million e shtatëqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë ) lekë pa TVSH.
3. "LEON KONSTRUKSION" sh.p.k me NIPT K71820009I me ofertën: 7 600 635 (shtatë million e gjashtëqind mije e gjashtëqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

4. " MANE/S"sh.p.k me NIPT J64103865K me ofertën: 6 826 124 (gjashtë million e tetëqind mijë e njëzetë e gjashtë mijë e njëqind e njëzetë katër ) lekë pa TVSH.
5. "SHENDELLI" sh.p.k me NIPT K07924803N mungon oferta pasi në dokumenta është ngarkuar vetem QKB.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. "JOGI" sh.p.k ka keto mangesi:

- Për punë te ngjashme Cogren ka paraqitur kontrate me objekt " Rikonstrukcion i objektit te zyrave Porti Himare" objekt I cili nuk mund të konsiderohet restaurim pasi është rikonstrukcion ndërtimor. Ky kriter konsiderohet i pa plotësuar.
- Shoqeria Cogren ka paraqitur vërtetim OSHEE më datë 30.04.2018 nga sektori i shitjeve të OSHEE Njësia Sarandë, firmosur nga Z. Feruz Basho, Vërtetim i cili nuk është në formën e kërkuar pasi Drejtori i Njesisë nuk ka të drejtë të japi vërtetim OSHEE për tender pasi një veretim i tillë mund të lëshohet nga Drejtoria Rajonale Gjirokastër. Në bazë të rregullores së OSHEE organ kompetent për lëshimin e vërtetimit të OSHEE për tender janë vetë Drejtoritë Rajonale të OSHEE.
- ELKRI& CO ose COGREN sh.p.k:  
Ka marrë përsiper në bazë të kontratës së bashkëpunimi 13% të punime, të restaurimit të murit të kalasë, dhe nuk ka paraqitur license të shoqërisë të restaurimit, Licence profesionale sipas modelit të lëshuar nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në Ministrinë e Kulturës (Kategoria C), nuk plotëson kriterin e vendosur ne DST. Gjithashtu ne zbatim te Vendimit 42 date 16.01.2008 te miratimin e rregullores se licensimit per personat juridik, shoqeria ELKRI ka detyrimin te beje ndryshimin e emrit te shoqerise brenda 30 ditesh .Ne sistem nuk është paraqitur licensa e re e shoqërisë me ndryshimet përkatëse, kreu VI, pika 4/a e kësaj rregullorje. Ndryshimi i emrit është bërë në QKR eshte bere ne date 12.02.2018. E njejta gje vlen edhe per ndryshimin e drejtuesit ligjore ne license pasika ndryshuar edhe administratori.
- Në bazë të Analizave të paraqitura në oferte për zërin R26 është përlogaritur cmimi 1950 lëke ndërkohë që në preventivin e ofertes është përcaktuar për zërin R26 cmimi 9950 lekë. Në këtë rast mospërputhja e cmimit të analizës së zërit R26 me atë të cmimit të ofertuar për këtë ze perben shkak per skualifikimin e ofertes tuaj.
- Nuk ka pike license zbatimimi NS-18 A

2. "COLOMBO" sh.p.k ka keto mangësi:

- Kategoria C) Punime restaurimi ne monumentet e arkitektures per shoqeri ndertimi ne restaurimin e monumeneteve te trashgimnise se arkitektures, Shoqeria COLOMBO nuk

paraqitur dokumentacion qe te provoje se e disponon kete license.

- Nga kontrolli i listepagesave te paraqitura nga kjo shoqeri , arkitekti J. Xuhano me kontrate pune date 13.07.2017 dhe A.Muka nuk jane te pasqyruar ne listpagesat e OE. Ky kriter konsiderohet i papermbushur.
- Vertetimi i OSHEE i paraqitur eshte i date 20.04.2018 nderkohe ne daten e hapjes se tenderit eshte maturuar edhe fatura e muajit Prill.
- Ne DST jane kerkuar përvvoja te mëparshme te ngjashme dhe per te plotesuar kete pike OE ka paraqitur kontrate per Rikonstruksion te ish shkolles se vjete Nivice dhe kontraten me objekt Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare rilindja Vlore. Te dyja keto kontrata jane rikonstruksion punime ndertimore dhe nuk jane restaurime monumentesh. Kontratat e paraqitura num plotesojne kriterin e vendosur ne dokumenta tenderi.

3. "SHENDELLI" ka këto mangësi:

- Munges dokumentacioni; Nuk ka paraqitur asnjë dokument përvec QKB-së.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik

" MANE/S"sh.p.k me NIPT J64103865K me ofertën: 6 826 124 (gjashtë million e tetëqind mijë e njëzetë e gjashtë mijë e njëqind e njëzetë katër ) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Berat, sigurimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brënda 30(tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes publikimit të këtij njoftimi. Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë,ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës,do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj , procedura do të anulohet siç parashikohet ligjin nr. 9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimet Publike" i ndryshuar me VKM nr 914 dt.29.12.2014 "Per miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 18.05.2015

Ankesa: nuk ka.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Petrit SINAJ**